GJIROKASTRA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA GJIROKASTER**

**Nr** 5536 **Prot**

**Gjirokastër më** 14.09 **.2016**

## KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;

**"Rikonstruksion i bulevardit 18 shtatori dhe degezimeve rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi"**

E lidhur sot me date **14.09.2016** ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve, bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , nenet 850 e ne vijim te tij, si dhe te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, sipas kushteve te meposhtme:

### KREU I : KUSHTET E VEÇANTA (PUNET)

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1: Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Znj. ZAMIRA RAMI** , nen cilesine e Kryetarit te Bashkise Gjirokaster, e njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte operatori ekonomik **"ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k me NIPT J61812013R me adrese:** Tirane, Rruga "Frederik Shiroka", Pallat i ri ,Shkalla B, Kati 2 , **perfaqesuar** nga administrator i shoqerise **z. Xhavit Ismaili , identifikuar me karte** [redacted] me poshte te quajtur si "**Kontraktuesi**", i cili perfaqeson kete shoqeri per detyrimet e kesaj kontrate.

**Neni 2 : Objekti**

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten 02.06.2016 dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin **"Rikonstruksion i bulevardit 18 shtatori dhe degezimeve rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi"** ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

**Neni 3 : Kantieri.**

Kantieri i punimeve do te jete: **"Bulevardi 18 shtatori dhe degezimet rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi"**

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**

Vlera e kontrates eshte **178 796 186,42** (njeqind e shtatedhjete e tete milione e shtateqind e nentedhjete e gjashte mije e njeqinde e tetedhjete e gjashte presje dyzet e dy ) **leke pa TVSH** dhe me vlere te pergjithshme **214 555 423,7** (dyqind e katermbedhjete milione e peseqind e pesedhjete e pese mije e katerqinde e njezete e tre presje shtate) **leke me t.v.sh.**

Scanned by CamScanner

**Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve**

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .
Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten **23.09.2016**
Afati i perfundimit te punimeve eshte date **22.03.2017**
kjo sipas afatit (6 muaj) te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi.
Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim.
Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42, date 16.01.2008 " Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjeketeve juridik qe ushtrojne veprimtari ndertimi", Kreu III.

**Neni 6 : Nderprerja e punimeve**
Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.
Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autorietit Kontraktor.

**Neni 7 : Sigurimi i Kontrates**
Sigurimi i kontrates i paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates ose ne vlere absolute **21 455 542, 3 (njezet e nje milion e katerqinde e pesedhjete e pese mije e peseqinde e dyzet e dy presje tre) leke.**
Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi. Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 8 : Garancia e Punimeve**
Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushte teknike te percaktuar me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij.
Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe 24 mujore duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve.
Shuma e mbajtur per efekt te garanacise se punimeve do te jete 5% e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise .
Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 24 mujore) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise per defektet si me siper.

**Neni 9: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 10 : Mbikeqyresi i Punimeve**

Autoriteti Kontraktor deklaron se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve te tij .

REPUBLIKA E SHQIPERISE



Scanned by CamScanner

Autoriteti Kontraktor deklaron se ne baze te ligjeve ne fuqi **Mbikeqyres i punimeve do te jete "ZENIT – 06" sh.p.k me nipt K61731002D me numer licence profesionale** "Per mbikeqyrje dhe kolaudim te punimeve te zbatimit" **MK 1208/8.**

Kontraktuesi duhet t'i neneshtrohet te gjitha dispozitave te mbikeqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.

Mbikeqyresi i punimeve do të njoftoje sipermarresin lidhur me çdo difekt para mbarimit të garancise të periudhes së garancise për difektet. Periudha e garancise së difekteve do të shtyhet deri sa të korrigjohen difektet.

Në qofte së sipermarresi nuk e korrigjon difektin brenda afatit të percaktuar në njoftimin e Mbikeqyresit të punimeve ky i fundit do të vleresoje koston e korrigjimit të difektit dhe sipermaresi do të paguaje këtë shume ose Autoriteti Kontraktor do ti mbaje këto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese, ose sigurimi i kontrates.

Perpara fillimit të punimeve sipermarresi do ti paraqese për miratim Mbikeqyresit të punimeve një program në të cilen tregohet menyra e kryerjes së punimeve, grafiku i punimeve Sipermarresi do të plotesoje programin sipas grafikut të parashikuar

**Neni 11 : Inspektimet dhe testimet , marrja ne dorezim e punimeve**

Inspektimet dhe testimet para vertetimit te Mbarimit te Puneve do te perfshijne te gjithe kontrollet, inspektimet, testimet qe do te kryeje Mbikeqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve , ne zbatim te dispozitave ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor mund te beje kontroll te gjithe dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve .Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithe demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

Marrja ne dorezim do te behet nga ana e Autoritetit Kontraktor pas perfundimit te kolaudimit te punimeve.

**Neni 12 : Lloji i Kontrates**

Kontrata është me cmime njesie të bazuar në cmimet e njesise të shprehura në preventivin ne njesi.

**Neni 13 : Ndryshimet e punimeve**

Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet , pervec se atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Cdo ndryshim ne sasi do te behet ne baze te nje propozimi teknik te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune te parashikuar ne preventiv.

Palet jane te detyruara qe per rastet te paparashikuara ne projekt te zbatojne kerkesat e neneve 860, te Kodit Civil si dhe nenet 35,36/1,2,3,4 te kushteve te pergjithshme te kontrates. Cmimet jashte kontrates caktohen sipas analizave teknike ne fuqi,me vleren ekonomike me te mire.

**Neni 14 : Grafiku dhe menyra e pageses.**

Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara, duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.

Mund te perpilohen dhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).

Kontraktuesi do ti paraqese Mbikeqyresit të punimeve situacionet pjesore për punimet e kryera , duke zbritur pagesat e situacioneve të meparshme , garancine e difekteve në vleren 5 % të vleres së situacionit pjesor .

Mbikeqyresi i punimeve do të firmose situacionin pasi te kontrolloje punen e kryer ne fakt nga sipermarresi dhe do të vertetoje shumen që do t'i paguhet sipermarresit .



Scanned by CamScanner

Situacionet pjesore te hartohen ne lloje, zera , sasi, cmime vlere,sipas kontrates dhe ndryshimeve te urdheruara nga investitori.
Zerat, sasite, cmimet jashte kontrates dhe perdorimi i fondit rezerve ne situacionin perfundimtar justifikohen me dokumentacionin ligjor perkates.
Vlera e punimeve të kryera do të percaktohet nga Mbikeqyresi i punimeve dhe do të perfshije vleren e volumeve të zerave të punimeve të perfunduara dhe të dhena ne preventiv.
Sipermarresi mbas perfundimit të punimeve i paraqet mbikeqyresit të punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare të punimeve të cilat Mbikeqyresi i punimeve mbasi ben verifikimin nga ana e tij së bashku me një relacion ia paraqet, Investitorit.
Pagesa nga ana e investitorit për punimet e kryera do t'i bëhet kontraktuesit me urdher xhirimi në llogarine rrjedhese **me Nr IBAN prane** [redacted]

Pagesa per Punet e kryera duhet bere brenda 30 diteve nga data qe kontraktuesi paraqet nje dokument (situacionin) qe deklaron se objektivi per pagesen eshte arritur.
Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

**Neni 15 : Detyrimet e Kontraktuesit**

Kontraktuesi (sipermarresi) , me qellim qe te kryeje punen ne kushte e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:

- Te perfundoje objektin sipas volumeve, zerave te pecaktuar ne preventiv si dhe ndryshimeve te miratuara , brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit.
- Te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furinizmin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve
- Te marre persiper te gjitha pergjegjesit qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

**Neni 16 : Detyrimet e Autoritetit Kontraktor**

Autoriteti Kontraktor ka detyrim:

- Sigurimin e skicave dhe mbikeqyrjen e punimeve
- Caktimi i mbikeqyresit te punimeve
- Marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skicave dhe preventivit te hartuar per kete qellim
- Pagesa e situacioneve.

**Neni 17 : Demet**

Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryere deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese , kur per to nuk eshte shkak forca madhore.
Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuar ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

**Neni 18: Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.



Scanned by CamScanner

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total I kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

**Neni 19 : Komunikimi midis paleve**
Komunikimi midis paleve duhet të bëhet vetem me shkrim . Njoftimi bëhet efektiv vetem pasi të dorezohet.

**Neni 20 : Gjuha e kontrates.**
Gjuha e kontrates eshte shqip.

**Neni 21 : Zgjidhja e mosmarreveshjeve**
Ne rast mosmarreveshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet , kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster.



Scanned by CamScanner

GJIROKASTRA

# REPUBLIKA E SHQIPERISE
## BASHKIA GJIROKASTER

**Nr. 5705 Prot** **Gjirokastër më 22.09. 2016**

### <u>KONTRATE PER SHERBIME</u>

**Kontrate Publike per kryerjen e sherbimit me objekt;**
**"Mbikeqyrje punimesh per objektin Rikonstruksion i bulevardit 18 shtatori dhe degezimeve rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi"**

E lidhur sot me daten 22.09.2016 ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar , bazuar ne Ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", i ndryshuar, ne UKM nr 03 date 15.02.2001 "Per mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

### <u>KREU I : KUSHTET E VEÇANTA (Sherbimet)</u>

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Znj.Zamira RAMI** kryetare e Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte operatori ekonomik **"ZENIT-06" sh.p.k me NIPT K61731002D, me nr licence MK 1202/8, date 21.12.2015** "Per mbikeqyrje dhe kolaudim te punimeve te zbatimit", **perfaqesuar nga administratori Z. Rexhep TARBA, me** [redacted]ni e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi".**

**Neni 2 : Objekti i kontrates**

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit Kerkes per Propozim (sherbimet) me daten 07.06.2016 dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit realizimin e sherbimit me objekt **"Mbikeqyrje punimesh per objektin Rikonstruksion i bulevardit 18 shtatori dhe degezimeve rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi"**, ne perputhje me specifikmet teknike dhe termat e references te dhena ne dokumentat e tenderit, te cilat jane pjese integrale e kesaj kontrate.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GJIROKASTER

STUDIM PROJEKTIM SUPERVIZION ZENIT 06 SH.P.K NIPT K61731002D



Scanned by CamScanner

**Çmimi i Kontratës**

Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**

Vlera totale e kontrates me objekt **"Mbikeqyrje punimesh per objektin Rikonstruksion i bulevardit 18 shtatori dhe degezimeve rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi"** sipas ofertes se paraqitur ne tender eshte **950 000** *(nenteqinde e pesedhjete mije* ) leke pa TVSH dhe me vlere te pergjithshme **1 140 000** (*nje milion e njeqinde e dyzete mije )* **leke me t.v.sh .**

Cmimi i parashikuar me siper perfshin te gjitha shpenzimet e kontraktuesit per sherbimin ne fjale , si dhe te gjitha detyrimet fiskale ne fuqi.

**Neni 5. Kushtet e pageses.**

Pagesa per sherbimin duhet bere sipas skedarit te meposhtem:

Pagesa e cmimit te kesaj kontrate do behet nga Autoriteti Kontraktor ne monedhen Lek nepermjet llogarise rjedhese te kontraktorit ne [redacted]

Pagesa do ti behet Kontraktuesit ne baze te perqindjes se situacioneve qe do te paraqiten per likujdim nga ana e shoqerise zbatuese te objektit, brenda 30(tridhjete) diteve nga paraqitja e tyre (situacioneve).

Data e pageses do te jete dita qe fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.Kur data e mesiperme eshte dite pushimi zyrtar, pagesa do te behet diten pasardhese te punes.

Kontraktuesi nuk do mare pagese paraprake.

**Neni 6 Afati i kontrates**

Sherbimi i mbikqyrjes do te zgjate per gjithe periudhen e zbatimit te punimeve, nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve te objektit **"Mbikeqyrje punimesh per objektin Rikonstruksion i bulevardit 18 shtatori dhe degezimeve rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi"** deri në përfundimin e plote te punimeve (perfshire dhe periudhen e garancise) .

**Neni 7 Vendodhja e sherbimit**

Kontraktuesi do te kryej sherbimin e mbykqyrjes me objekt: **"Mbikeqyrje punimesh per objektin Rikonstruksion i bulevardit 18 shtatori dhe degezimeve rr. Rrexhep Qosja dhe "Gole Gushi".**

**Neni 8 Sigurimi i Kontrates**

Sigurimi i kontrates i paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates ose ne vlere absolute **114.000 (njeqind e katermbedhjete mije) leke.** Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi. Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GJIROKASTER



Scanned by CamScanner

## Neni 9 Siguracioni i Përgjegjsisë Profesionale

Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithesi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

## Neni 10 Te drejtat dhe detyrimet e paleve

Te bien dakort per kushtet qe vijojne:

1. Mbykqyresi i punimeve nuk duhet te jete i lidhur ne asnje menyre me zbatimin e objektit qe do te drejtoje.

2. Menjehere me lidhjen e kontrates autoriteti kontraktor i dorezon mbykqyresit te punimeve informacion dhe dokumentat e objektit per te cilin eshte ngarkuar te kryej mbikqyrjen.

3. Mbikqyresi i punimeve do te vihet ne dijeni nga Autoriteti Kontraktor per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh subjekti zbatues, ne perputhje me kontraten e nenshkruar.

4. Mbikqyresi i sherbimeve pervec sherbimeve te kontrollit per zbatimin e punimeve , duhet te ndjek edhe grafikun e punimeve.

5. Mbikeqyresi i punimeve studion plan-organizimin e punimeve

6. Per objektin qe ndertohet , mbikqyresi i punimeve mban dhe pergjigjet per dokumentacionin percaktuar ne UKM nr 3 date 15.02.2001 "Per mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" i ndryshuar.

7. Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht, dhe ne fazen me kryesore, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per saktesin dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te si dhe cilesine e punimeve te ndertimit.

8. Ne castin e fillimit te punimeve , mbykqyresi i punimeve duhet te beje verifikimet paraprake si meposhte:
   - Konstatimi i ndryshimeve qe mund te kene ndodhur ne vendin ku do te zbatohet vepra, qe nga koha e projektimit e deri ne momentin e fillimit te punimeve.
   - Verifikimin e te gjithe dokumentacionit perkates, te licencave, te autorizimeve dhe te lejeve te cilat, sipas dispozitave ne fuqi, duhen te meren para fillimit te punimeve;
   - Verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet;

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GJIROKASTER



Scanned by CamScanner

- Njohjen me hollesi te kontrates te sipermarrjes lidhur midis autoritetit kontraktor dhe subjektin zbatues si dhe te gjitha akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes;

- Vendosjen e tabeles se indentifikimit me te dhenat e meposhtme;

a) Emertimi i objektit;

b) Data e marjes se lejes se ndertimit;

c) Investitori;

d) Projektuesi;

e) Subjekti zbatues dhe drejtuesi teknik;

f) Mbykqyresi;

g) Afati i ndertimit;

h) Siperfaqja e ndertimit;

10. Mbikqyresi i punimeve, pas verifikimeve te percaktuara ne piken 9 (pjesa e 1) te U.K.M. nr 3 dt 15.02.2001 , te ndryshuar , duhet te hartoje dokumentacionin e meposhtem;

- Aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit shoqerise sipermarese;

- Aktin e dorezimit nga subjekti zbatues te dokumentacionit teknik dhe administrativ, si licenca , autorizime e leje te marra nga subjekti zbatues;

- Shkresen me ane te se ciles njofton Autoritetin Kontraktor per fillimin e punimeve;

11. Mbikqyresi i punimeve , gjate zbatimit te objektit,i jep instruksione dhe urdhera, me shkrim subjektit zbatues sa here qe e sheh te nevojshme, ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore dhe ky i fundit eshte i detyruar ti respektoje ato , por duke ruajtur te drejten ti beje me shkrim Autoritetit Kontraktues verejtjet e tij, per instruksionet dhe urdherat e mbykqyresit te punimeve.

12. Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose te disa personave nga personeli i subjekti zbatues.per te realizuar kete , ai i drejtohet me shkrim titullarit te shoqerise zbatuese , duke i shpjeguar arsyet.Arsyet kryesore te propozimit per largim munde te jene moszbatimi i standarteve dhe i rregullave teknike, mosbindja , paaftesia , arbitrariteti ne zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi te renda.

13. Mbikeqyresi i punimeve ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materialeve per te verifikuar cilesine e tyre Materialet qe vijne ne kantier duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te porjektit . materialet ne veper perdoren vetem me miratimin e mbikeqyrsit te punimeve . Materialet e ardhura si dhe pajisjet e siguruara nga subjekti zbatues por qe nuk pranohen nga mbikeqyresi , zevendesohen me te tjera , me shpenzimet e subjektit zbatues. Ne keto raste(si per materialet ashtu edhe per pisjet) mosparnimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ... STËR-

Scanned by CamScanner

duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave te provave sebashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve te detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.

14. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të subjektit zbatues(sipërmarrësit).

15. Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të subjektit zbatues (sipërmarrësit), në rast të kundërt, subjekti zbatues (sipërmarrësi) ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

16. Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.

17. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton çdo muaj investitorit për realizimin e tij. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Subjekti zbatues (sipermarresi) duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur punimet janë gati për t'u ekzaminuar prej tij.

18. Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike, të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.Kete informacion te detajuar mbikeqyresi I punimeve eshte I detyruara t'ja raportoje Autoritetit Kontraktues.

19. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara ose jo me cilësi.

20. Me perfundimin e punimeve , brenda 30 ditëve, mbikëqyrësi i punimeve duhet t'i kerkoje me shkrim subjektit zbatues qe te paraqese:

a. *Kontratën dhe aktet që lidhen me të.*
b. *Regjistrimin e kontabilitetit.*
c. *Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.*
ç. *Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.*
d. *Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Scanned by CamScanner

GJIROKASTRA

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
## BASHKIA E QYTETIT

Gjirokastër, më 15/07/2014

Tel: ++355 84 26 4103/ 26 2424/ 26 3500
Tel&Fax: ++355 84 26 3796
Address: Bashkia Gjirokastër, Albania
Nr.2138 Prot.
Zyra e Kryetarit

***Lenda : Mbi emerimin e mbikqyresit te punimeve ne objektin:"* Projekte ne parkun e Viroit"**: 1)Sistemim i parkut te Viroit, 2)Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit, 3)Ndricim i trotuarit ne parkun e viroit nga ana e qytetit

Në zbatim të ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ",te ndryshuar , neni 7 për emerimin e mbikqyresit dhe ne UKM nr 3 , date 15.02.2001 'Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar

**URDHEROJ :**

1. Te emerohet mbikeqyres i punimeve per objektin "**Projekte ne parkun e Viroit"**: 1)Sistemim i parkut te Viroit, 2)Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit, 3)Ndricim i trotuarit ne parkun e viroit nga ana e qytetit te prokuruar ne vitin 2014 Ing. Antoneta Çako sipas tabeles se meposhtme ;

| Nr | OBJEKTI | Vlera e objektit (leke) | Mbikqyres i punimeve |
|---|---|---|---|
| 1 | **Objekti: "Projekte ne parkun e Viroit"**: 1)Sistemim i parkut te Viroit, 2)Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit, 3)Ndricim i trotuarit ne parkun e viroit nga ana e qytetit | 50 399 203 | Ing. Antoneta Çako |

2. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA GJIROKASTER

**KRYETARI**

**FLAMUR BIME**

Scanned by CamScanner

BASHKIA GJIROKASTER

# KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

OBJEKTI KONTRATES; *"PROJEKTE NE PARKUN E VIROIT"*

*PALET KONTRAKTUESE:*

INVESTITORI; *"BASHKIA GJIROKASTER"*

KONTRAKTUESI; BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIKE
*"A.L-ASFALT "SH.P.K NIPT K81511508A DHE*
*"ERAL CONSTRUCTION COMPANY" SH.P.K ME NIPT K82230002K*

VITI 2014

AL - ASFALT sh.p.k Ndërtim - Import - Export Nipt. K81511508A

Scanned by CamScanner

# FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: " " **Projekte ne parkun e Viroit": 1)Sistemim i parkut te Viroit, 2)Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit, 3)Ndricim i trotuarit ne parkun e viroit nga ana e qytetit.**

Kjo Kontratë është lidhur më **22.07.2014** midis **Bashkise Gjirokaster** tani e tutje të referuar si "**Autoriteti Kontraktor**" përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor **Z. Flamur BIME** Kryetar i Bashkise dhe bashkimit te operatoreve ekonomike **"A.L - Asfalt" SH.P.K me Nipt K81511508A dhe "Eral Construction Company" sh.p.k Tirane me NIPT K82230002K me kontrate** bashkepunimi Nr 3333 rep, date 12.06.2014 dhe prokure te posacme perfaqesimi Nr 3334 rep, date 12.06.2014 perfaqesuar nga **Z. ASTRIT VARAKU** si perfaqesues ligjor i shoqerise"A.L - Asfalt" SH.P.K dhe **Z.ERVIN QENDRO** perfaqesues i shoqerise "Eral Construction Company" sh.p.k tani e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi".**
Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar Prokurimit me objekt: "" **Projekte ne parkun e Viroit": 1)Sistemim i parkut te Viroit, 2)Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit, 3)Ndricim i trotuarit ne parkun e viroit nga ana e qytetit.**

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 13.06.2014 bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kërkesat e pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.
Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **41 999 336** ( dyzete e nje milione e nenteqind e nentedhjete e nente mije e treqind e tridhjete e gjashte ) leke pa t.v.sh dhe

AL - ASFALT Sh.p.k Ndërtim - Import - Export K81511508A

Scanned by CamScanner

me vlere te pergjithshme **50 399 203**( pesedhjete milione e treqinde e nentedhjete e nente mije e dyqind e tre ) leke me t.v.sh për realizimin e Punëve;

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: ***5.039.920 (Pese milione e tridhjete e nente mije e nenteqind e njezet leke)*** dhe në formën e Kompani Sigurimesh, ose garanci bankare, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.

5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 22.07.2014 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**BASHKIA GJIROKASTER**
PËRFAQËSUAR NGA
KRYETARI

**FLAMUR BIME**

**KONTRAKTUESI**
***"A.L - Asfalt" SH.P.K dhe***
**" Eral Construction Company" sh.p.k**
PËRFAQËSUAR NGA
PER ***"A.L - Asfalt" SH.P.K***

**Z. ASTRIT VARAKU**

**Eral Construction Company** sH.P.K

**Z. Z. ERVIN QENDRO**

**Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokaster**

**Nr tel : 084 26 35 00**

**Nr tel mob** [redacted]



Jurist.
Semi Golemi

Scanned by CamScanner

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**BASHKIA E QYTETIT**

**GJIROKASTER**

---

## KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;
" **Projekte ne parkun e Viroit": 1)Sistemim i parkut te Viroit, 2)Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit, 3)Ndricim i trotuarit ne parkun e viroit nga ana e qytetit.**

E lidhur sot me daten 22.07.2014 ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , neni 850 e vijim dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

## KREU I : KUSHTET E VECANTA (PUNET)

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Z.FLAMUR BIME** kryetar i Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte bashkimi i operatoreve ekonomike **"A.L - Asfalt" SH.P.K me Nipt K81511508A dhe "Eral Construction Company" sh.p.k Tirane me NIPT K82230002K me kontrate** bashkepunimi Nr 3333 rep, date 12.06.2014 dhe prokure te posacme perfaqesimi Nr 3334 rep, date 12.06.2014 perfaqesuar nga **Z . ASTRIT VARAKU** si perfaqesues ligjor i shoqerise"**A.L - Asfalt" SH.P.K** dhe **Z.ERVIN QENDRO** perfaqesues i shoqerise "Eral Construction Company" sh.p.k tani e tutje te quajtur si "**Kontraktuesi** te cilet perfaqesojne kete bashkim operatoresh per detyrimet e kesaj kontrate.

AL - ASFALT Sh.p.k Ndërtim - Import - Export Nipt. K81511508A Xhafzotaj - Durrës



Scanned by CamScanner

**Neni 2 : Objekti**

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten **13.06.2014** dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin **"Projekte ne parkun e Viroit": 1)Sistemim i parkut te Viroit, 2)Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit, 3)Ndricim i trotuarit ne parkun e viroit nga ana e qytetit.** ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

**Neni 3 : Kantieri**

Kantieri i punimeve do te jete parku Virua Gjirokaster.

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**

Vlera totale e kontrates eshte **50 399 203**( pesedhjete milione e treqind e nentedhjete e nente mije e dyqind e tre ) leke me t.v.sh

**Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve**

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .
Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten **23.07. 2014**
Afati i perfundimit te punimeve eshte date **22.11. 2014**
kjo sipas afatit te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi.
Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim.
Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42 date 16.01.2008 kreu III .

**Neni 6 : Nderprerja e punimeve**

Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.
Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autorietit Kontraktor.

**Neni 7 : Sigurimi i Kontrates**

Garancia e kontrates e paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10%

AL - ASFALT Sh.p.k Ndërtim - Import - Export K51511508A Xhafzotaj - Durrës



Scanned by CamScanner

te vleres se kontrates ose ne vlere absolute ***5.039.920 (Pese milione e tridhjete e nente mije e nenteqind e njezet leke.*** Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi.

**Neni 8 : Garancia e Punimeve**

Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushte teknike te percaktuar me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij.
Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe 12 mujore duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve.
Shuma e mbajtur per efekt te garanacise se punimeve do te jete 5% e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise (**12 muaj).**
Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 12 mujore) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise per defektet si me siper.

**Neni 9 : Mbikeqyresi i Punimeve**

Autoriteti Kontraktor deklaron se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve te tij .
Autoriteti Kontraktor deklaron se ne baze te ligjeve ne fuqi ***Mbikeqyres i punimeve do te jete*** **Ing Antoneta Çako_me nr licence _MK 1693 .**
Kontraktuesi duhet t'i neneshtohet te gjitha dispozitave te mbikeqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.
Mbikeqyresi i punimeve do të njoftoje sipermarresin lidhur me çdo difekt para mbarimit të garancise të periudhes së garancise për difektet . Periudha e garancise së difekteve do të shtyhet deri sa të korrigjohen difektet.
Në qofte së sipermarresi nuk e korrigjon difektin brenda afatit të percaktuar në njoftimin e Mbikeqyresit të punimeve ky i fundit do të vleresoje koston e korrigjimit të difektit dhe sipermaresi do të paguaje këtë shume ose Autoriteti Kontraktor do ti mbaje këto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese, ose sigurimi i kontrates.
Perpara fillimit të punimeve sipermarresi do ti paraqese për miratim Mbikeqyresit të punimeve një program në të cilen tregohet menyra e kryerjes së punimeve , grafiku i punimeve Sipermarresi do të plotesoje programin sipas grafikut të parashikuar

AL - ASFALT Sh.p.k
Ndërtim - Import - Export
Nipt K81511506A
Xhafzotaj - Durrës

Scanned by CamScanner

**Neni 10 : Inspektimet dhe testimet , marrja ne dorezim e punimeve**

Inspektimet dhe testimet para vertetimit te Mbarimit te Puneve do te perfshijne te gjithe kontrollet, inspektimet, testimet qe do te kryeje Mbikeqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve , ne zbatim te dispozitave ne fuqi.
Autoriteti Kontraktor mund te beje kontroll te gjithe dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve .Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithe demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.
Autorieti Kontraktor do te kryeje verifikimin perfundimtar te punimeve brenda 5 (pese) ditesh nga data e perfundimit te punimeve.
Marrja ne dorezim do te behet nga ana e Autoritetit Kontraktor pas perfundimit te kolaudimit te punimeve.

**Neni 11 : Lloji i Kontrates**

Kontrata është me cmime njesie të bazuar në cmimet e njesise të shprehura në preventivin ne njesi.

**Neni 12 : Ndryshimet e punimeve**

Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet , pervec se atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
Cdo ndryshim ne sasi do te behet ne baze te nje propozimi teknik te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune te parashikuar ne preventiv.
Palet jane te detyruara qe per rastet te paparashikuara ne projekt te zbatojne kerkesat e neneve 860, 862 te Kodit Civil si dhe nenet 35,36/1,2,3,4 te kushteve te pergjithshme te kontrates.
Cmimet jashte kontrates caktohen sipas analizave teknike ne fuqi,me vleren ekonomike me te mire. (Udhezimi Nr2 dt 13.05.2005KM).

**Neni 13 : Grafiku dhe menyra e pageses.**

Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara ,duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.
Mund te perpilohen dhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).
Kontraktuesi do ti paraqese Mbikeqyresit të punimeve situacionet pjesore për punimet e kryera , duke zbritur pagesat e situacioneve të

AL - ASFALT Sh.p.k Ndërtim - Import - Export



Scanned by CamScanner

meparshme , garancine e difekteve në vleren 5 % të vleres së situacionit pjesor .
Mbikeqyresi i punimeve do të firmose situacionin pasi te kontrolloje punen e kryer ne fakt nga sipermarresi dhe do të vertetoje shumen që do t'i paguhet sipermarresit .
Situacionet pjesore te hartohen ne lloje, zera , sasi, cmime vlere,sipas kontrates dhe ndryshimeve te urdheruara nga investitori.
Zerat, sasite, cmimet jashte kontrates dhe perdorimi i fondit rezerve ne situacionin perfundimtar justifikohen me dokumentacionin perkates.(Udhezimi Nr2 dt 13.05.2005KM)

Vlera e punimeve të kryera do të percaktohet nga Mbikeqyresi i punimeve dhe do të perfshije vleren e volumeve të zerave të punimeve të perfunduara dhe të dhena ne preventiv.
Sipermarresi mbas perfundimit të punimeve i paraqet mbikeqyresit të punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare të punimeve të cilat Mbikeqyresi i punimeve mbasi ben verifikimin nga ana e tij së bashku me një relacion ia paraqet, Investitorit.
Pagesa nga ana e investitorit për punimet e kryera do t'i bëhet [redacted]
kontraktuesi paraqet nje dokument (situacionin) qe deklaron se objektivi per pagesen eshte arritur.
Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

**Neni 14 : Detyrimet e Kontraktuesit**

Kontraktuesi (sipermarresi) , me qellim qe te kryeje punen ne kushte e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:

- Te perfundoje objektin sipas volumeve, zerave te pecaktuar ne preventiv si dhe ndryshimeve te miratuara , brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit.
- Te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furinizmin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve
- Te marre persiper te gjitha pergjegjesit qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

**Neni 15 : Detyrimet e Autoritetit Kontraktor**

Autoriteti Kontraktor ka detyrim



Scanned by CamScanner

- Sigurimin e skicave dhe mbikeqyrjen e punimeve
- Caktimi i mbikeqyresit te punimeve
- Marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skicave dhe preventivit te hartuar per kete qellim
- Pagesa e situacioneve.

**Neni 16 : Demet**

Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryere deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese , kur per to nuk eshte shkak forca madhore.
Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuar ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

**Neni 17 : Komunikimi midis paleve**

Komunikimi midis paleve duhet të bëhet vetem me shkrim . Njoftimi bëhet efektiv vetem pasi të dorezohet

**Neni 18 : Gjuha e kontrates.**

Gjuha e kontrates eshte shqip.

**Neni 19 : Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Ne rast mosmarreveshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet , kompetence per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokastër.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**BASHKIA GJIROKASTER**

PËRFAQËSUAR NGA
KRYETARI

**FLAMUR BIME**

**KONTRAKTUESI**
**"*A.L - Asfalt*" SH.P.K *dhe***
**" Eral Construction Company" sh.p.k**
PËRFAQËSUAR NGA
PER **"*A.L - Asfalt*" SH.P.K**

**Z. ASTRIT VARAKU**
**Eral Construction Company s**H.P.K

**Z. Z. ERVIN QENDRO**

**Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokaster**

**Nr tel : 084 26 35 00**

**Nr tel mob:** [redacted]



Juriot:
Sem: Golemi:

Scanned by CamScanner

GJIROKASTRA

# REPUBLIKA E SHQIPERISE
## BASHKIA GJIROKASTER

Nr.5353 Prot　　　　　　　　　　　　　　　　Gjirokastër më 29. 12. 2015

## KONTRATE PER SHERBIME

**Kontrate Publike per kryerjen e sherbimit me objekt;**

**"Mbikqyrje punimesh ne objektin: Rikonstruksion i rruges Sheshi i Cercizit - Postobllok"**

E lidhur sot me daten 29.12.2015 ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , neni 850 e vijim dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar , bazuar ne Ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar, ne UKM nr 03 date 15.02.2001 "Per mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndrtimit" i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

## KREU I : KUSHTET E VECANTA (SHERBIMET)

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do te mbizoterojne ato te Kushteve te veçanta te kontrates.

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Znj.Zamira RAMI** kryetare e Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte operatori ekonomik **"MAK STUDIO " sh.p.k me NIPT L01422017O me nr licence**"Per mbikeqyrje dhe kolaudim te punimeve te zbatimit" **MK1811/4 , date 27.05.2015 perfaqesuar** nga **Z. Tomorr SPAHIU** administrator i subjektit **"MAK STUDIO " sh.p.k** tani e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi".**

**Neni 2 : Objekti i kontrates**

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten_**07.12.2015** dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit realizimin e sherbimit me objekt **"Mbikqyrje punimesh ne objektin: Rikonstruksion i rruges Sheshi i Cercizit - Postobllok"**

**Neni 3 Çmimi i Kontratës**

Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.



Scanned by CamScanner

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**

Vlera totale e kontrates me objekt "**Mbikqyrje punimesh ne objektin: Rikonstruksion i rruges Sheshi i Cercizit - Postobllok**" sipas ofertes se paraqitur ne tender eshte **531 000** (peseqind e tridhjet e nje mije ) leke pa TVSH dhe me vlere te pergjithshme **637 200** (gjashteqind e tridhjet e shtate mije e dyqind) **leke me t.v.sh .**

Cmimi i parashikuar me siper perfshin te gjitha shpenzimet e kontraktuesit per sherbimin ne fjale , si dhe te gjitha detyrimet fiskale ne fuqi.

**Neni 5. Kushtet e pageses.**

Pagesa per sherbimin duhet bere sipas skedarit te meposhtem:

Pagesa e cmimit te kesaj kontrate do behet nga Autoriteti Kontraktor ne monedhen Lek nepermjet Bankes_______________________________, ne llogarine e Kontraktuesit nr.______________________________________________________________________.

Pagesa do ti behet Kontraktuesit ne baze te perqindjes se situacioneve qe do te paraqiten per likujdim nga ana e shoqerise zbatuese te objektit, brenda 30(tridhjete) diteve nga paraqitja e tyre (situacioneve).

Data e pageses do te jete dita qe fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.Kur data e mesiperme eshte dite pushimi zyrtar, pagesa do te behet diten pasardhese te punes.

Kontraktuesi nuk do mare pagese paraprake.

**Neni 6 Sigurimi i kontrates**

Garancia e kontrates e paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates ose ne vlere absolute **63720 (gjashtedhjete e tre mije e shtateqind e njezet) leke.** Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 7 Afati i kontrates**

Afati i kryerjes se sherbimit,objekt kontrate ,nga kontraktuesi do te jete 12 muaj nga dita qe do te lidhet kontrata e sipermarjes midis Bashkise Gjirokaster dhe Subjektit zbatues.

**Neni 8 Vendodhja e sherbimit**

Kontraktuesi do te kryej sherbimin e mbykqyrjes me objekt:"Rikonstruksioni i rruges Sheshi Cercizit Postbllok"

**Neni 9 Siguracioni i Përgjegjsisë Profesionale**

Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.



Scanned by CamScanner

**Neni 10 Te drejtat dhe detyrimet e paleve**

Te bien dakort per kushtet qe vijojne:

1. Mbykqyresi i punimeve nuk duhet te jete i lidhur ne asnje menyre me zbatimin e objektit qe do te drejtoje.

2. Menjehere me lidhjen e kontrates autoriteti kontraktor i dorezon mbykqyresit te punimeve informacion dhe dokumentat e objektit per te cilin eshte ngarkuar te kryej mbikqyrjen.

3. Mbikqyresi i punimeve do te vihet ne dijeni nga Autoriteti Kontraktor per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh subjekti zbatues, ne perputhje me kontraten e nenshkruar.

4. Mbikqyresi i sherbimeve pervec sherbimeve te kontrollit per zbatimin e punimeve , duhet te ndjek edhe grafikun e punimeve.

5. Per objektin qe ndertohet , mbikqyresi i punimeve mban dhe pergjigjet per dokumentacionin percaktuar ne UKM nr 3 date 15.02.2001 “Per mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit” i ndryshuar.

6. Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht, dhe ne fazen me kryesore, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per saktesin dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te si dhe cilesine e punimeve te ndertimit.

7. Ne castin e fillimit te punimeve , mbykqyresi i punimeve duhet te beje verifikimet paraprake si mepshte:

- Verifikimin e te gjithe dokumentacionit perkates, te licencave, te autorizimeve dhe te lejeve te cilat, sipas dispozitave ne fuqi, duhen te meren para fillimit te punimeve;

- Verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet;

- Njohjen me hollesi te kontrates te sipermarrjes lidhur midis autoritetit kontraktor dhe subjektin zbatues si dhe te gjitha akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes;

- Vendosjen e tabeles se indentifikimit me te dhenat e meposhtme;

a) Emertimi i objektit;

b) Data e marjes se lejes se ndertimit;

c) Investitori;

d) Projektuesi;



Scanned by CamScanner

e) Subjekti zbatues dhe drejtuesi teknik;

f) Mbykqyresi;

g) Afati i ndertimit;

h) Siperfaqja e ndertimit;

8. Mbikqyresi i punimeve, pas verifikimeve te percaktuara ne piken 9 (pjesa e 1) te U.K.M. nr 3 dt 15.02.2001 , te ndryshuar , duhet te hartoje dokumentacionin e meposhtem;

- Aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit shoqerise sipermarese;

- Aktin e dorezimit nga subjekti zbatues te dokumentacionit teknik dhe administrativ, si licenca , autorizime e leje te marra nga subjekti zbatues;

- Shkresen me ane te se ciles njofton Autoritetin Kontraktor per fillimin e punimeve;

9. Mbikqyresi i punimeve , gjate zbatimit te objektit,i jep instruksione dhe urdhera, me shkrim subjektit zbatues sa here qe e sheh te nevojshme, ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore dhe ky i fundit eshte i detyruar ti respektoje ato , por duke ruajtur te drejten ti beje me shkrim Autoritetit Kontraktues verejtjet e tij, per instruksionet dhe urdherat e mbykqyresit te punimeve.

10. Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose te disa personave nga personeli i subjekti zbatues.per te realizuar kete , ai i drejtohet me shkrim titullarit te shoqerise zbatuese , duke i shpjeguar arsyet.Arsyet kryesore te propozimit per largim munde te jene moszbatimi i standarteve dhe i rregullave teknike, mosbindja , paaftesia , arbitrariteti ne zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi te renda.

11. Materialet qe vijne ne kantier duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te porjektit . materialet ne veper perdoren vetem me miratimin e mbikeqyrsit te punimeve . Materialet e ardhura si dhe pajisjet e siguruara nga subjekti zbatues por qe nuk pranohen nga mbikeqyresi , zevendesohen me te tjera , me shpenzimet e subjektit zbatues. Ne keto raste(si per materialet ashtu edhe per pisjet) mosparnimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave te provave sebashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve te detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.

12. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të subjektit zbatues(sipërmarrësit).

13. Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të subjektit zbatues (sipërmarrësit), në rast të kundërt, subjekti zbatues (sipërmarrësi) ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

14. Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar



Scanned by CamScanner

ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.

15. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton çdo muaj investitorit për realizimin e tij. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Subjekti zbatues (sipermarresi) duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur punimet janë gati për t'u ekzaminuar prej tij.

16. Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike, të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.Kete informacion te detajuar mbikeqyresi I punimeve eshte I detyruara t'ja raportoje Autoritetit Kontraktues.

17. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:
- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara ose jo me cilësi.

18. Me perfundimin e punimeve , brenda 30 ditëve, mbikëqyrësi i punimeve duhet t'i kerkoje me shkrim subjektit zbatues qe te paraqese:
a. *Kontratën dhe aktet që lidhen me të.*
*b. Regjistrimin e kontabilitetit.*
c. *Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.*
ç. *Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.*
*d. Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.*
Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithçka që ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore, së bashku me subjektit zbatues (sipermarresin). Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.

19. Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.

20. Situacionet e paraqitura nga subjektit zbatues,(sipermarresi) në fazat e ndryshme të punimeve kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve. Pagesa mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi. Këto dokumente dërgohen në sektorin financiar të



Scanned by CamScanner

punëdhënësit, bashkë me vërtetimin e përkohshëm të pagesës, për të shpallur vlerën e detyrueshme për pagim.

21. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër,përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur subjektit zbatues (sipermarresit) , si dhe i jepet për likujdim Autoritetit Kontraktues (investitorit.).

22. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar, dhe i raporton, periodikisht, Autoritetit Kontraktues (investitorit) për gjendjen e tij. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton subjektin zbatues (sipërmarrësin) dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

23. Autoriteti Kontraktor nuk i ben pagesen mbikeqyresit te punimeve nese konstaton se nuk jane respektuar dispozitat ligjore dhe nenligjore per realizimin e kontrates dhe mbikeqyrjes se punimeve.

24. Ne perfundim te periudhes se garancise Autoriteti Kontraktor , Kolaudatori, mbikeqyresi dhe zbatuesi I punimeve duhet te bejne kontrollin perfundimtarte vepres. Per defektet qe nuk jane ndrequr gjate periudhes se garancise se punimeve te ndertimit Autoriteti Kontraktues llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlera e garancise se punimeve.

25. Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontaktor ose dikasteri nga varet ky Autoritet Kontraktor , si dhe Inspektoriati ndertimor e Urbanistik vendor/kombetar , kanë të drejtë të urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës, deri në marrjen e masave përkatëse, për normalizimin e gjendjes..

26. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione, në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

27. Mbikeqyresi I punimeve mban pergjegjesi ligjore per mosrespektin te kushteve te kesaj kontrate dhe akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

**Neni 11 Dispozita te fundit.**

Kontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te saj nga palet.

Palet e kesaj kontrate duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.



Scanned by CamScanner

GJIROKASTRA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA GJIROKASTER**

**Nr.** 5366 **Prot** **Gjirokastër më** 30 . 12 . **2015**

## KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;
**"Rikonstruksion i rruges Sheshi i Cercizit – Postobllok"**

E lidhur sot me daten 30 / 12 /**.2015** ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , neni 850 e vijim dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

## KREU I : KUSHTET E VECANTA (PUNET)

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Znj. Zamira RAMI** kryetare e Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte bashkimi i operatoreve '**ALBA KONSTRUKSION" SHPK me nipt J61812013R & "FUSHA " SHPK** me nipt **J61922018S me** kontrate noteriale bashkepunimi Nr 626 rep, date 11.10.2015 , dhe me prokure te posacme perfaqesimi Nr 627 rep, dhe Nr. 356 kol date 11.10.2015 per operatorin ekonomik "**ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k** me adrese Tirane , Rr. Frederik Shiroka, pallati i ri, shkalla B, kati II **perfaqesuar nga**:

**Z. Xhavit ISMAILI** administratori i shoqerise **"ALBA KONSTRUKSION" SHPK**

**dhe nga Z. Shkelqim FUSHA administrator i shoqerise "FUSHA" sh.p.k** tani e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi"** te cilet perfaqesojne kete bashkim operatoresh ekonomike per detyrimet e kesaj kontrate.

REPUBLIKA E SHQIPERISE – BASHKIA GJIROKASTËR

SHOQERIA E NDERTIMIT Alba Konstruksion SH.P.K NIPT: J61812013R TIRANA - ALBANIA



Scanned by CamScanner

**Neni 2 : Objekti**

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten **12.10.2015** dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin "**Rikonstruksion i rruges Sheshi i Cercizit – Postobllok**" ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

**Neni 3 : Kantieri**

Kantieri i punimeve do te jete rruga **rruga nga Sheshi i Cercizit – PostobllokGjirokaster.**

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**

Vlera totale e kontrates eshte **197 289 292,81** (njeqind e nentedhjete e shtate milion e dyqind e tetedhjete e nente mije e dyqind e nentedhjete e dy presje tetedhjete e nje ) **leke me t.v.sh.**

**Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve**

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .
Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten 30 / 12 / **.2015**
Afati i perfundimit te punimeve eshte date 29 / 12 / **.2016**
kjo sipas afatit prej 12 muaj te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi. Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim. Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42 date 16.01.2008 kreu III .

**Neni 6 : Nderprerja e punimeve**

Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.
Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autorietit Kontraktor.

**Neni 7 Ndërprerja për Mosplotësim**

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA GJIROKASTËR
SHOQERIA E NDERTIMIT Alba Konstruksion SH.P.K NIPT : J61812013R TIRANA - ALBANIA



Scanned by CamScanner

**Neni 8: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 9: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet

**Neni 10 : Sigurimi i Kontrates**

Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

Sigurimi i kontrates i paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates ose ne vlere absolute **19 728 929 (nentembedhjete milione e shtateqind e njezete e tete mije e nenteqind e njezet e nente) leke.**

Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi.

Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës

**Neni 11 : Garancia e Punimeve.**

Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushte teknike te percaktuar me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij.
Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe 24 mujore duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve.
Shuma e mbajtur per efekt te garanacise se punimeve do te jete 5% e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise .
Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 24 mujore) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise per defektet si me siper.

**Neni 12: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA GJIROKASTËR

SHOQERIA E NDERTIMIT Albo Konstruksion SH.P.K NIPT : J618...



Scanned by CamScanner

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 13 : Sigurimi**

Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes ne kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anulluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

**Neni 14 : Mbikeqyresi i Punimeve**

Autoriteti Kontraktor deklaron se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve te tij .
Autoriteti Kontraktor deklaron se ne baze te ligjeve ne fuqi ***Mbikeqyres i punimeve do te jete*** **shoqeria" M.A.K STUDIO " sh.p.k me nr licence _MK 1811/4 date 27.05.2015.**
Kontraktuesi duhet t'i neneshtohet te gjitha dispozitave te mbikeqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.
Mbikeqyresi i punimeve do të njoftoje sipermarresin lidhur me çdo difekt para mbarimit të garancise të periudhes së garancise për difektet . Periudha e garancise së difekteve do të shtyhet deri sa të korrigjohen difektet.
Në qofte së sipermarresi nuk e korrigjon difektin brenda afatit të percaktuar në njoftimin e Mbikeqyresit të punimeve ky i fundit do të vleresoje koston e korrigjimit të difektit dhe sipermaresi do të paguaje këtë shume ose Autoriteti Kontraktor do ti mbaje këto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese, ose sigurimi i kontrates.
Perpara fillimit të punimeve sipermarresi do ti paraqese për miratim Mbikeqyresit të punimeve një program në të cilen tregohet menyra e kryerjes së punimeve , grafiku i punimeve Sipermarresi do të plotesoje programin sipas grafikut të parashikuar

**Neni 15 : Inspektimet dhe testimet , marrja ne dorezim e punimeve**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... GJIROKASTER

SHOQERIA E NDERTIMIT Alba Konstruksion SH.P.K NIPT: J61... TIRANA



Scanned by CamScanner

Inspektimet dhe testimet para vertetimit te Mbarimit te Puneve do te perfshijne te gjithe kontrollet, inspektimet, testimet qe do te kryeje Mbikeqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve , ne zbatim te dispozitave ne fuqi.
Autoriteti Kontraktor mund te beje kontroll te gjithe dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve .Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithe demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.
Autorieti Kontraktor do te kryeje verifikimin perfundimtar te punimeve brenda 5 (pese) ditesh nga data e perfundimit te punimeve.
Marrja ne dorezim do te behet nga ana e Autoritetit Kontraktor pas perfundimit te kolaudimit te punimeve.

**Neni 16 : Lloji i Kontrates**

Kontrata është me cmime njesie të bazuar në cmimet e njesise të shprehura në preventivin ne njesi.

**Neni 17 : Ndryshimet e punimeve**

Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet , pervec se atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
Cdo ndryshim ne sasi do te behet ne baze te nje propozimi teknik te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune te parashikuar ne preventiv.
Palet jane te detyruara qe per rastet te paparashikuara ne projekt te zbatojne kerkesat e neneve 860, te Kodit Civil si dhe nenet 35,36/1,2,3,4 te kushteve te pergjithshme te kontrates. Cmimet jashte kontrates caktohen sipas analizave teknike ne fuqi,me vleren ekonomike me te mire.

**Neni 18 : Grafiku dhe menyra e pageses.**
Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara ,duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.
Mund te perpilohen dhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).
Kontraktuesi do ti paraqese Mbikeqyresit të punimeve situacionet pjesore për punimet e kryera , duke zbritur pagesat e situacioneve të meparshme , garancine e difekteve në vleren 5 % të vleres së situacionit pjesor .
Mbikeqyresi i punimeve do të firmose situacionin pasi te kontrolloje punen e kryer ne fakt nga sipermarresi dhe do të vertetoje shumen që do t'i paguhet sipermarresit .
Situacionet pjesore te hartohen ne lloje, zera , sasi, cmime vlere,sipas kontrates dhe ndryshimeve te urdheruara nga investitori.
Zerat, sasite, cmimet jashte kontrates dhe perdorimi i fondit rezerve ne situacionin perfundimtar justifikohen me dokumentacionin ligjor perkates. (Udhezimi Nr 2 dt 13.05.2005 KM)
Vlera e punimeve të kryera do të percaktohet nga Mbikeqyresi i punimeve dhe do të perfshije vleren e volumeve të zerave të punimeve të perfunduara dhe të dhena ne preventiv.
Sipermarresi mbas perfundimit të punimeve i paraqet mbikeqyresit të punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare të punimeve të cilat Mbikeqyresi i

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJIROKASTER

SHOQERIA E NDERTIMIT Alba Konstruksion SH.P.K. NIPT J61812... TIRANA - ALBANIA



Scanned by CamScanner

punimeve mbasi ben verifikimin nga ana e tij së bashku me një relacion ia paraqet, Investitorit.

Pagesa nga ana e investitorit për punimet e kryera do t'i bëhet kontraktuesit me urdher xhirimi në llogarine [redacted] rrjedhese [redacted]

Pagesa per Punet e kryera duhet bere brenda 30 diteve nga data qe kontraktuesi paraqet nje dokument (situacionin) qe deklaron se objektivi per pagesen eshte arritur.
Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

**Neni 19 : Detyrimet e Kontraktuesit**

Kontraktuesi (sipermarresi) , me qellim qe te kryeje punen ne kushte e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:

- Te perfundoje objektin sipas volumeve, zerave te pecaktuar ne preventiv si dhe ndryshimeve te miratuara , brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit.
- Te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furinizmin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve
- Te marre persiper te gjitha pergjegjesit qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

**Neni 20 : Detyrimet e Autoritetit Kontraktor**

Autoriteti Kontraktor ka detyrim

- Sigurimin e skicave dhe mbikeqyrjen e punimeve
- Caktimi i mbikeqyresit te punimeve
- Marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skicave dhe preventivit te hartuar per kete qellim
- Pagesa e situacioneve.

**Neni 21 : Demet**

Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryere deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese , kur per to nuk eshte shkak forca madhore.
Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuar ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

**Neni 22: Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total I kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.



Scanned by CamScanner

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

**Neni 23 : Komunikimi midis paleve**

Komunikimi midis paleve duhet të bëhet vetem me shkrim . Njoftimi bëhet efektiv vetem pasi të dorezohet.

**Neni 24 : Gjuha e kontrates.**

Gjuha e kontrates eshte shqip.

**Neni 25 : Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Ne rast mosmarreveshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet , kompetence per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokastër.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**BASHKIA GJIROKASTER**

PËRFAQËSUAR NGA

**KRYETAR**

**ZAMIRA RAMI**

(Vula: REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GJIROKASTËR)

**KONTRAKTUESI**
**"ALBA KONSTRUKSION" SH.P.K**
**DHE "FUSHA" SH.P.K**

PËRFAQËSUAR
PER ALBA KONSTRUKSION SH.P.K

**Z.** XHAVIT ISMAILI

(Vula: SHOQERIA E NDERTIMIT Alba Konstruksion SH.P.K TIRANA - ALBANIA)

**PER "FUSHA" SH.P.K**

**Z.** SHKELQIM FUSHA

(Vula: fusha tel/fax ++355 4 254 78.. tirana albania)



Scanned by CamScanner

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA GJIROKASTER**

**URDHER**

Nr.452 Date 26 / 08 /2016

**Mbi emerimin e mbikeqyresit te punimeve per objektin:**

**"Rikualifikim i hapesirave publike dhe rruges hyrese prane Memorialit te Rilindasve Gjirokaster"**

Në zbatim të ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ",i ndryshuar, dhe ne UKM nr 3 , date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar:

**URDHEROJ:**

1. Te emerohet mbikeqyres i punimeve ne objektin **"Rikualifikim i hapesirave publike dhe rruges hyrese prane Memorialit te Rilindasve Gjirokaster", bashkimi i operatoreve ekonomike "Taulant" sh.p.k & "Vler-Invest" sh.p.k & "Arkimade" sh.p.k, sipas kontrates se dates 19.01.2015 lidhur ndermjet FZHR-se** (perfaqesuar nga z. **Benet BECI) dhe BOE te sipercituar** (sipas tabeles me poshte).

| Nr | OBJEKTI | Mbikeqyres i punimeve | Zbatues i punimeve |
|---|---|---|---|
| 1 | "Rikualifikim i hapesirave publike dhe rruges hyrese prane Memorialit te Rilindasve Gjirokaster" | Bashkimi i operatoreve ekonomike "Taulant" sh.p.k & "Vler-Invest" sh.p.k & "Arkimade" sh.p.k | "BOSHNJAKU B " sh.p.k |

2. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETAR**

**ZAMIRA RAMI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA GJIROKASTER

Scanned by CamScanner

56

GJIROKASTRA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA GJIROKASTER**

**Nr. 5355 Prot** **Gjirokastër më 06.09. 2016**

## KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;

**"Rikualifikim i hapesirave publike dhe rruges hyrese prane Memorialit te Rilindasve Gjirokaster"**

E lidhur sot me date **06.09.2016** ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve, bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , nenet 850 e ne vijim te tij, si dhe te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, sipas kushteve te meposhtme:

### KREU I : KUSHTET E VEÇANTA (PUNET)

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Znj. ZAMIRA RAMI** , nen cilesine e Kryetarit te Bashkise Gjirokaster, e njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte operatori ekonomik **"BOSHNJAKU B " sh.p.k me NIPT K72627402H me adrese:** FIER, Lagjja Bishanake, Rruga Skenderbeu, Nr. 8, Prane karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr 8532 , **perfaqesuar me prokure te posaçme me nr.Rep.3731 dhe Kol.2330, te dates 05.09.2016, e noteres Flora Xh.ZOTO, Dhoma e Noterise Vlore,** nga Z. Alban MUHARREMI, pajisur [redacted] tani e tutje te quajtur si "**Kontraktuesi** i cili perfaqeson kete shoqeri per detyrimet e kesaj kontrate.

**Neni 2 : Objekti**
Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten 18.07.2016 dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin **"Rikualifikim i hapesirave publike dhe rruges hyrese prane Memorialit te Rilindasve Gjirokaster",** ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

**Neni 3 : Kantieri.**

Kantieri i punimeve do te jete: **"Hapesirat publike dhe rruga prane Memorialit te Rilindasve Gjirokaster".**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BOSHNJAKU B. sh.p.k Kompani ndërtimi NIPT:K72627402H FIER

Scanned by CamScanner

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**
Vlera e kontrates eshte **48 516 872** (dyzet e tete milion e peseqinde e gjashtembedhjete mije e teteqinde e shtatedhjete e dy ) **leke pa TVSH,** dhe me vlere te pergjithshme **58 220 247** (pesedhjete e tete milion e dyqinde e njezete mije e dyqinde e dyzet e shtate ) **leke me t.v.sh**

**Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve**

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .
Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten **06.09. 2016**
Afati i perfundimit te punimeve eshte date **01.07. 2017**
kjo sipas afatit (300 dite) te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi.
Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim.
Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42, date 16.01.2008 " Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjeketeve juridik qe ushtrojne veprimtari ndertimi", Kreu III.

**Neni 6 : Nderprerja e punimeve**
Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.
Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autorietit Kontraktor.

**Neni 7 : Sigurimi i Kontrates**

Sigurimi i kontrates i paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates ose ne vlere absolute **5 822 025 (pese milion e teteqinde e njezet e dy mije e njezet e pese ) leke.** Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi. Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 8 : Garancia e Punimeve**
Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushte teknike te percaktuar me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij.
Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe 2 vjecare(24 muaj) , duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve.
Shuma e mbajtur per efekt te garanacise se punimeve do te jete 5% e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise .
Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 2-vjecare) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise per defektet si me siper.

**Neni 9: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 10 : Mbikeqyresi i Punimeve**

BOSHNJAKU.B SHPK Kompani ndërtimi NIPT:K72627462H FIER



Scanned by CamScanner

Autoriteti Kontraktor deklaron se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve te tij .
Autoriteti Kontraktor deklaron se ne baze te ligjeve ne fuqi **Mbikeqyres i punimeve do te jete bashkimi i operatoreve ekonomike "Taulant" sh.p.k & "Vler-Invest" sh.p.k & "Arkimade" sh.p.k, sipas kontrates se dates 19.01.2015 lidhur ndermjet FZHR-se (perfaqesuar nga z. Benet BECI) dhe BOE te sipercituar.**
Kontraktuesi duhet t'i neneshtrohet te gjitha dispozitave te mbikeqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.
Mbikeqyresi i punimeve do të njoftoje sipermarresin lidhur me çdo difekt para mbarimit të garancise të periudhes së garancise për difektet . Periudha e garancise së difekteve do të shtyhet deri sa të korrigjohen difektet.
Në qofte së sipermarresi nuk e korrigjon difektin brenda afatit të percaktuar në njoftimin e Mbikeqyresit të punimeve ky i fundit do të vleresoje koston e korrigjimit të difektit dhe sipermaresi do të paguaje këtë shume ose Autoriteti Kontraktor do ti mbaje këto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese, ose sigurimi i kontrates.
Perpara fillimit të punimeve sipermarresi do ti paraqese për miratim Mbikeqyresit të punimeve një program në të cilen tregohet menyra e kryerjes së punimeve , grafiku i punimeve Sipermarresi do të plotesoje programin sipas grafikut të parashikuar

**Neni 11 : Inspektimet dhe testimet , marrja ne dorezim e punimeve**

Inspektimet dhe testimet para vertetimit te Mbarimit te Puneve do te perfshijne te gjithe kontrollet, inspektimet, testimet qe do te kryeje Mbikeqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve , ne zbatim te dispozitave ne fuqi.
Autoriteti Kontraktor mund te beje kontroll te gjithe dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve .Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithe demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
Marrja ne dorezim do te behet nga ana e Autoritetit Kontraktor pas perfundimit te kolaudimit te punimeve.

**Neni 12 : Lloji i Kontrates**
Kontrata është me cmime njesie të bazuar në cmimet e njesise të shprehura në preventivin ne njesi.

**Neni 13 : Ndryshimet e punimeve**
Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet , pervec se atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
Cdo ndryshim ne sasi do te behet ne baze te nje propozimi teknik te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune te parashikuar ne preventiv.
Palet jane te detyruara qe per rastet te paparashikuara ne projekt te zbatojne kerkesat e neneve 860, te Kodit Civil si dhe nenet 35,36/1,2,3,4 te kushteve te pergjithshme te kontrates. Cmimet jashte kontrates caktohen sipas analizave teknike ne fuqi,me vleren ekonomike me te mire.

**Neni 14 : Grafiku dhe menyra e pageses.**
Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara, duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.
Mund te perpilohen dhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).

BOSHNJAKU.B SHPK Kompani ndërtimi NIPT:K72627402H FIER



Scanned by CamScanner

Kontraktuesi do ti paraqese Mbikeqyresit të punimeve situacionet pjesore për punimet e kryera , duke zbritur pagesat e situacioneve të meparshme , garancine e difekteve në vleren 5 % të vleres së situacionit pjesor .
Mbikeqyresi i punimeve do të firmose situacionin pasi te kontrolloje punen e kryer ne fakt nga sipermarresi dhe do të vertetoje shumen që do t'i paguhet sipermarresit .
Situacionet pjesore te hartohen ne lloje, zera , sasi, cmime vlere,sipas kontrates dhe ndryshimeve te urdheruara nga investitori.
Zerat, sasite, cmimet jashte kontrates dhe perdorimi i fondit rezerve ne situacionin perfundimtar justifikohen me dokumentacionin ligjor perkates.
Vlera e punimeve të kryera do të percaktohet nga Mbikeqyresi i punimeve dhe do të perfshije vleren e volumeve të zerave të punimeve të perfunduara dhe të dhena ne preventiv.
Sipermarresi mbas perfundimit të punimeve i paraqet mbikeqyresit të punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare të punimeve të cilat Mbikeqyresi i punimeve mbasi ben verifikimin nga ana e tij së bashku me një relacion ia paraqet, Investitorit.
Pagesa nga ana e investitorit për punimet e kryera do t'i bëhet kontraktuesit me urdher xhirimi në llogarine rrjedhese [redacted]
Pagesa per Punet e kryera duhet bere brenda 30 diteve nga data qe kontraktuesi paraqet nje dokument (situacionin) qe deklaron se objektivi per pagesen eshte arritur.
Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

**Neni 15 : Detyrimet e Kontraktuesit**

Kontraktuesi (sipermarresi) , me qellim qe te kryeje punen ne kushte e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:

- Te perfundoje objektin sipas volumeve, zerave te pecaktuar ne preventiv si dhe ndryshimeve te miratuara , brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit.
- Te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furinizmin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve
- Te marre persiper te gjitha pergjegjesit qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

**Neni 16 : Detyrimet e Autoritetit Kontraktor**

Autoriteti Kontraktor ka detyrim:

- Sigurimin e skicave dhe mbikeqyrjen e punimeve
- Caktimi i mbikeqyresit te punimeve
- Marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skicave dhe preventivit te hartuar per kete qellim
- Pagesa e situacioneve.

**Neni 17 : Demet**

Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryere deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese , kur per to nuk eshte shkak forca madhore.
Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuar ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

**Neni 18: Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

BOSHNJAKU.B shpk Kompani ndërtimi NIPT:K72627402H FIER



Scanned by CamScanner

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total I kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

**Neni 19 : Komunikimi midis paleve**

Komunikimi midis paleve duhet të bëhet vetem me shkrim . Njoftimi bëhet efektiv vetem pasi të dorezohet.

**Neni 20 : Gjuha e kontrates.**

Gjuha e kontrates eshte shqip.

**Neni 21 : Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Ne rast mosmarreveshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet, kompetence per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster.

BOSHNJAKU Kompani ndërtimi NIPT:K72627402H FIER



Scanned by CamScanner

GJIROKASTRA

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# BASHKIA E QYTETIT

Gjirokastër, më 01/07/2014

Tel: ++355 84 26 4103/ 26 2424/ 26 3500
Tel&Fax: ++355 84 26 3796
Address: Bashkia Gjirokastër, Albania
Nr. 1962 Prot.
Zyra e Kryetarit

**Lenda : Mbi emerimin e mbikqyresit te punimeve ne objektin:" Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese"**

Në zbatim të ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ",te ndryshuar , neni 7 për emerimin e mbikqyresit dhe ne UKM nr 3 , date 15.02.2001 'Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar:

**URDHEROJ :**

1. Te emerohet mbikeqyres i punimeve per objektin ***" Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese"*** te prokuruar ne vitin 2014 Ing. Gaqe Meçi sipas tabeles se meposhtme ;

| Nr | OBJEKTI | Vlera e objektit | Mbikeqyres |
|---|---|---|---|
| 1 | ***" Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese"*** | **27.086.739** | Ing.Gaqe Meçi |

2 .Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA GJIROKASTER

**KRYETARI**

**FLAMUR BIME**

Scanned by CamScanner

# BASHKIA GJIROKASTER

# KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

**OBJEKTI KONTRATES;** *"RRUGA PRANE SHTEPISE SE ISMAIL KADARESE"*

*PALET KONTRAKTUESE:*

**INVESTITORI;** ***"BASHKIA GJIROKASTER"***

**KONTRAKTUESI;** ***"DERVENI-1"SH.P.K*** **NIPT** *K49322548U*

Firma Private
DERVENI-1 sh.p.k
ndert. proj.
Import - Eksport
Tepelene ALBANIA

Scanned by CamScanner

## FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: " ***Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese***"

Kjo Kontratë është lidhur më 09/07/2014 midis **Bashkise Gjirokaster** tani e tutje të referuar si "**Autoriteti Kontraktor**" përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor **Z. Flamur BIME** Kryetar i Bashkise dhe shoqerise ***" DERVENI-1"SHPK*** perfaqesuar nga **Z. Reshat ZIKA perfaqesues ligjor i shoqerise "*DERVENI 1"SHPK*** tani e tutje te quajtur si "**Kontraktuesi"**. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar Prokurimit me objekt: "***Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese***"

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 06.06.2014 bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kërkesat e pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.
Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **22.572.283** ( njezet e dy milione e peseqind e shtatedhjete e dy mije e dyqind e tetedhjete e tre ) Leke pa tvsh dhe me vlere te pergjithshme **27.086.739** ( njezete shtate milione e tetedhjete e gjashte mije e shtateqind e tridhjete e nente) leke me t.v.sh për realizimin e Punëve;

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: ***2 708 674 (dy milione e shtateqind e tete mije e gjashteqind e shtatedhjete e kater ) leke*** dhe në formën e Kompani Sigurimesh, ose garanci bankare, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA

1

Firma Private DERVENI-1 sh.p.k Tepelene ALBANIA

Scanned by CamScanner

2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.

5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 09/07/.2014 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

| | |
|---|---|
| **AUTORITETI KONTRAKTOR**<br>**BASHKIA GJIROKASTER**<br>PËRFAQËSUAR NGA<br>KRYETARI | **KONTRAKTUESI**<br>**"DERVENI 1"SH.P.K.**<br>PËRFAQËSUAR NGA |
| **FLAMUR BIME** | **Z.RESHAT ZIKA** |
| **Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokaster** | |
| **Nr tel : 084 26 35 00** | **Nr tel mob:** [redacted] |



Scanned by CamScanner

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**BASHKIA E QYTETIT**

**GJIROKASTER**

---

# KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;
***" Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese"***

E lidhur sot me daten 09/07/2014 ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , neni 850 e vijim dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

## KREU I : KUSHTET E VECANTA (PUNET)

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Z.FLAMUR BIME** kryetar i Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte ***" DERVENI-1"SHPK me nipt K49322548U*** perfaqesuar nga **Z. Reshat ZIKA perfaqesues ligjor i shoqerise "*DERVENI 1 " SHPK*** tani e tutje te quajtur si "**Kontraktuesi** i cili perfaqeson kete shoqeri per detyrimet e kesaj kontrate.

**Neni 2 : Objekti**

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten **06.06.2014** dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin " ***Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese*** "ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA GJIROKASTER

Firma Private DERVENI 1 sh.p.k Ndertim - projektim Import - Eksport Tepelene ALBANIA

Scanned by CamScanner

**Neni 3 : Kantieri**

Kantieri i punimeve do te jete rruga prane shtepise se Ismail Kadarese Gjirokaster.

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**

Vlera totale e kontrates eshte **27.086.739** ( njezet e shtate milione e tetedhjete e gjashte mije e shtateqind e tridhjete e nente) leke me t.v.sh .

**Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve**

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .
Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten 10/07/2014
Afati i perfundimit te punimeve eshte date 10/12/2014
kjo sipas afatit te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi.
Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim.
Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42 date 16.01.2008 kreu III .

**Neni 6 : Nderprerja e punimeve**

Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.
Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autorietit Kontraktor.

**Neni 7 : Sigurimi i Kontrates**

Garancia e kontrates e paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates ose ne vlere absolute ***2 708 674 (dy milione e shtateqind e tete mije e gjashteqind e shtatedhjete e kater ) leke.*** Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi.

**Neni 8 : Garancia e Punimeve**

Firma Private DERVENI-1 sh.p.k. ndert. prod. Import Eksport Tepelene ALBANIA



Scanned by CamScanner

Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushte teknike te percaktuar me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij.
Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe 12 mujore duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve.
Shuma e mbajtur per efekt te garanacise se punimeve do te jete 5% e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise (**12 muaj).**
Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 12 mujore) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise per defektet si me siper.

**Neni 9 : Mbikeqyresi i Punimeve**

Autoriteti Kontraktor deklaron se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve te tij .
Autoriteti Kontraktor deklaron se ne baze te ligjeve ne fuqi ***Mbikeqyres i punimeve do te jete*** **Ing. GAQE MEÇI _me nr licence MK 0626/1**
Kontraktuesi duhet t'i neneshtohet te gjitha dispozitave te mbikeqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.
Mbikeqyresi i punimeve do të njoftoje sipermarresin lidhur me çdo difekt para mbarimit të garancise të periudhes së garancise për difektet . Periudha e garancise së difekteve do të shtyhet deri sa të korrigjohen difektet.
Në qofte së sipermarresi nuk e korrigjon difektin brenda afatit të percaktuar në njoftimin e Mbikeqyresit të punimeve ky i fundit do të vleresoje koston e korrigjimit të difektit dhe sipermaresi do të paguaje këtë shume ose Autoriteti Kontraktor do ti mbaje këto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese, ose sigurimi i kontrates.
Perpara fillimit të punimeve sipermarresi do ti paraqese për miratim Mbikeqyresit të punimeve një program në të cilen tregohet menyra e kryerjes së punimeve , grafiku i punimeve Sipermarresi do të plotesoje programin sipas grafikut të parashikuar

**Neni 10 : Inspektimet dhe testimet , marrja ne dorezim e punimeve**

Inspektimet dhe testimet para vertetimit te Mbarimit te Puneve do te perfshijne te gjithe kontrollet, inspektimet, testimet qe do te kryeje Mbikeqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve , ne zbatim te dispozitave ne fuqi.

Firma Private DERVENI-Sh.p.k Tepelene ALBANIA

Scanned by CamScanner

Autoriteti Kontraktor mund te beje kontroll te gjithe dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve .Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithe demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.
Autorieti Kontraktor do te kryeje verifikimin perfundimtar te punimeve brenda 5 (pese) ditesh nga data e perfundimit te punimeve.
Marrja ne dorezim do te behet nga ana e Autoritetit Kontraktor pas perfundimit te kolaudimit te punimeve.

**Neni 11 : Lloji i Kontrates**

Kontrata është me cmime njesie të bazuar në cmimet e njesise të shprehura në preventivin ne njesi.

**Neni 12 : Ndryshimet e punimeve**

Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet , pervec se atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
Cdo ndryshim ne sasi do te behet ne baze te nje propozimi teknik te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune te parashikuar ne preventiv.
Palet jane te detyruara qe per rastet te paparashikuara ne projekt te zbatojne kerkesat e neneve 860, 862 te Kodit Civil si dhe nenet 35,36/1,2,3,4 te kushteve te pergjithshme te kontrates.
Cmimet jashte kontrates caktohen sipas analizave teknike ne fuqi,me vleren ekonomike me te mire. (Udhezimi Nr2 dt 13.05.2005KM).

**Neni 13 : Grafiku dhe menyra e pageses.**

Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara ,duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.
Mund te perpilohen dhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).
Kontraktuesi do ti paraqese Mbikeqyresit të punimeve situacionet pjesore për punimet e kryera , duke zbritur pagesat e situacioneve të meparshme , garancine e difekteve në vleren 5 % të vleres së situacionit pjesor .
Mbikeqyresi i punimeve do të firmose situacionin pasi te kontrolloje punen e kryer ne fakt nga sipermarresi dhe do të vertetoje shumen që do t'i paguhet sipermarresit .
Situacionet pjesore te hartohen ne lloje, zera , sasi, cmime vlere,sipas kontrates dhe ndryshimeve te urdheruara nga investitori.

Firma Private DERVENI sh.p.k. Import Export Tepelene ALBANIA

Scanned by CamScanner

Zerat, sasite, cmimet jashte kontrates dhe perdorimi i fondit rezerve ne situacionin perfundimtar justifikohen me dokumentacionin perkates.(Udhezimi Nr2 dt 13.05.2005KM)

Vlera e punimeve të kryera do të percaktohet nga Mbikeqyresi i punimeve dhe do të perfshije vleren e volumeve të zerave të punimeve të perfunduara dhe të dhena ne preventiv.
Sipermarresi mbas perfundimit të punimeve i paraqet mbikeqyresit të punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare të punimeve të cilat Mbikeqyresi i punimeve mbasi ben verifikimin nga ana e tij së bashku me një relacion ia paraqet, Investitorit.
Pagesa nga ana e investitorit për punimet e kryera do t'i bëhet [redacted]
Pagesa per Punet e kryera duhet bere brenda 30 diteve nga data qe kontraktuesi paraqet nje dokument (situacionin) qe deklaron se objektivi per pagesen eshte arritur.
Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

**Neni 14 : Detyrimet e Kontraktuesit**

Kontraktuesi (sipermarresi) , me qellim qe te kryeje punen ne kushte e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:

- Te perfundoje objektin sipas volumeve, zerave te pecaktuar ne preventiv si dhe ndryshimeve te miratuara , brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit.
- Te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furinizmin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve
- Te marre persiper te gjitha pergjegjesit qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

**Neni 15 : Detyrimet e Autoritetit Kontraktor**

Autoriteti Kontraktor ka detyrim

- Sigurimin e skicave dhe mbikeqyrjen e punimeve
- Caktimi i mbikeqyresit te punimeve
- Marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skicave dhe preventivit te hartuar per kete qellim
- Pagesa e situacioneve.

**Neni 16 : Demet**

Scanned by CamScanner

Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryere deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese , kur per to nuk eshte shkak forca madhore.

Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuar ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

**Neni 17 : Komunikimi midis paleve**

Komunikimi midis paleve duhet të bëhet vetem me shkrim . Njoftimi bëhet efektiv vetem pasi të dorezohet

**Neni 18 : Gjuha e kontrates.**

Gjuha e kontrates eshte shqip.

**Neni 19 : Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Ne rast mosmarreveshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet , kompetence per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokastër.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**BASHKIA GJIROKASTER**
PËRFAQËSUAR NGA
KRYETARI

**FLAMUR BIME**

**Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokaster**

**Nr tel : 084 26 35 00**

**KONTRAKTUESI**
**"DERVENI 1"SH.P.K.**
PËRFAQËSUAR NGA

**Z.RESHAT ZIKA**

**Nr tel mob:** [redacted]

Scanned by CamScanner

(51)

GJIROKASTRA


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA E QYTETIT**

Gjirokastër, më 29/07/2014

Tel: ++355 84 26 4103/ 26 2424/ 26 3500
Tel&Fax: ++355 84 26 3796
Address: Bashkia Gjirokastër, Albania
Nr.2239 Prot.
Zyra e Kryetarit


***Lenda : Mbi emerimin e mbikqyresit te punimeve ne objektin:" LOTI 1 : Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat.***

Në zbatim të ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ",te ndryshuar , neni 7 për emerimin e mbikqyresit dhe ne UKM nr 3 , date 15.02.2001 'Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar:

**URDHEROJ :**

1. Te emerohet mbikeqyres i punimeve per objektin ***"LOTI 1 : Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat.":*** te prokuruar ne vitin 2014 Ing. Gaqe MEÇI sipas tabeles se meposhtme ;

| Nr | OBJEKTI | Vlera e objektit (leke) | Mbikqyres i punimeve |
|---|---|---|---|
| 1 | ***LOTI 1 : Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat.*** | 23 894 592 | Ing. Gaqe MEÇI |

II.Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA GJIROKASTËR

**KRYETARI**

**FLAMUR BIME**

Juristi
Semi Golemi

Scanned by CamScanner

50

fl 1-22

# BASHKIA GJIROKASTER

# KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

OBJEKTI KONTRATES; **LOTI 1 : *Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat.***

*PALET KONTRAKTUESE:*

*INVESTITORI;* *"BASHKIA GJIROKASTER"*

KONTRAKTUESI; BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIKE
**"Bashkimi-L" SHPK me NIPT J64103475Q dhe**
**"Elkri & CO" SHPK me NIPT J74818825K**

VITI 2014

Scanned by CamScanner

# FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **"Infrastrukture rrugore ne qytet"**

***LOTI 1 : Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat.***

Kjo Kontratë është lidhur më **05.08.2014** midis **Bashkise Gjirokaster** tani e tutje të referuar si "**Autoriteti Kontraktor**" përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor **Z. Flamur BIME** Kryetar i Bashkise dhe bashkimit te operatoreve ekonomike ***"Bashkimi-L" SHPK me NIPT J64103475Q dhe "Elkri & CO" SHPK me NIPT J74818825K"*** me kontrate bashkepunimi **Nr 1913 Rep, Nr 767 Kol , date 19.06.2014 ,perfaqesuar** nga **Z. ISA DERVISHI** perfaqesues ligjor i shoqerise**"Bashkimi-L" sh.p.k** dhe **Znj. Fotina RONDO** perfaqesues i shoqerise **"ELKRI&CO"** sh.p.k tani e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi".**

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar Prokurimit me objekt: Loti 1 ***Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat***

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 20.06.2014 bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kërkesat e pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **19 912 160** (nentembedhjete milione e nenteqind e dymbedhjete mije e njeqind e gjashtedhjete ) **leke pa t.v.sh** dhe me vlere te pergjithshme **23 894 592** ( njezet e tre milione e teteqind e nentedhjete e kater mije e peseqind e nentedhjete e dy ) leke me t.v.sh për realizimin e Punëve;

Scanned by CamScanner

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: ***2 389 459 (dy milione e treqind e tetedhjete e nente mije e katerqind e pesedhjete e nente leke)*** në formën e Kompani Sigurimesh, ose garanci bankare, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.

5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 05.08.2014 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

| | |
|---|---|
| **AUTORITETI KONTRAKTOR**<br>**BASHKIA GJIROKASTER**<br><br>PËRFAQËSUAR NGA<br>KRYETARI<br><br>**FLAMUR BIME**<br><br>**Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokaster**<br><br>**Nr tel : 084 26 35 00** | **KONTRAKTUESI**<br>***"BASHKIMI/L" SH.P.K dhe***<br>**" ELKRI&CO" sh.p.k**<br>PËRFAQËSUAR NGA<br>Per **"**BASHKIMI/L" SH.P.K<br><br>**Z . ISA DERVISHI**<br><br>Per "ELKRI&CO" sh.p.k<br><br>**Znj. FOTINA RONDO**<br><br>**Nr tel mob:** [redacted] |

Jurist:
Semi Colomi

Scanned by CamScanner

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**BASHKIA E QYTETIT**

**GJIROKASTER**

---

# KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;

***Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat***

E lidhur sot me daten 05.08.2014 ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , neni 850 e vijim dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar sipas kushteve te meposhtme:

## KREU I : KUSHTET E VECANTA (PUNET)

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Z.FLAMUR BIME** kryetar i Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte bashkimi i operatoreve ekonomike ***"Bashkimi-L" SHPK me NIPT J64103475Q dhe "Elkri & CO" SHPK me NIPT J74818825K"*** me kontrate bashkepunimi **Nr 1913 Rep, Nr767 Kol , date 19.06.2014 , perfaqesuar nga Z. ISA DERVISHI** si perfaqesues ligjor i shoqerise**"Bashkimi-L" sh.p.k** dhe **Znj. Fotina RONDO** perfaqesues i shoqerise **"ELKRI&CO"** sh.p.k tani e tutje te quajtur si **"Kontraktuesi"** te cilet perfaqesojne kete bashkim operatoresh per detyrimet e kesaj kontrate.

Scanned by CamScanner

## Neni 2 : Objekti

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten_**20.06.2014** dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin ***Infrastrukture rrugore ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat"*** ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

## Neni 3 : Kantieri

Kantieri i punimeve do te jete rrugica ne qendren historike, ne lagjet Dunavat 1 dhe 2, Cfake dhe Manalat Gjirokaster.

## Neni 4 : Vlera e Kontrates

Vlera totale e kontrates eshte **23 894 592** ( njezet e tre milione e teteqind e nentedhjete e kater mije e peseqind e nentedhjete e dy ) leke me t.v.sh

## Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .
Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten **05.08.2014**
Afati i perfundimit te punimeve eshte date **04.12. 2014**
kjo sipas afatit te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi.
Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim.
Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42 date 16.01.2008 kreu III .

## Neni 6 : Nderprerja e punimeve

Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.
Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autorietit Kontraktor.

## Neni 7 : Sigurimi i Kontrates

Shpk Ndërtim Prodhim Tregti BASHKIMI Dervishi LUSHNJË ALBANIA

Scanned by CamScanner

**Neni 20 : Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Ne rast mosmarreveshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet , kompetence per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokastër.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**BASHKIA GJIROKASTER**

PËRFAQËSUAR NGA
KRYETARI

**FLAMUR BIME**

**Adresa ; Sheshi i Cercizit Gjirokaster**

**Nr tel : 084 26 35 00**

**KONTRAKTUESI**
***"BASHKIMI/L" SH.P.K dhe***
**" ELKRI&CO" sh.p.k**
PËRFAQËSUAR NGA
Per ***"BASHKIMI/L" SH.P.K***

**Z . ISA DERVISHI**

**Per "ELKR&CO" sh.p.k**

**Znj. FOTINA RONDO**

**Nr tel mob:** [redacted]

Juristi
Semi Golemi

Scanned by CamScanner

GJIROKASTRA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT

Gjirokastër, më 06 / 11 /2014

Tel: ++355 84 26 4103/ 26 2424/ 26 3500
Tel&Fax: ++355 84 26 3796
Address: Bashkia Gjirokastër, Albania
Nr.3222 Prot.
Zyra e kryetarit

**Lenda : Mbi emerimin e mbikeqyresit te punimeve ne objektin:" "Shetitorja Gjirokaster -parku i viroit (pedonale dhe ndricim)"**

Në zbatim të ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ",te ndryshuar , neni 7 për emerimin e mbikqyresit dhe ne UKM nr 3 , date 15.02.2001 'Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar:

**URDHEROJ :**

1. Te emerohet mbikeqyres i punimeve per objektin *"Shetitorja Gjirokaster -parku i viroit (pedonale dhe ndricim)"* te prokuruar ne vitin 2014 Ing. Gaqe MEÇI me Nr licence **MK 0626/1 dhe Ing. Antoneta Çako me nr licence MK1693** sipas tabeles se meposhtme ;

| Nr | OBJEKTI | Vlera e objektit ne leke | Mbikeqyres i punimeve |
|---|---|---|---|
| 1 | *Shetitorja Gjirokaster -parku i viroit (pedonale dhe ndricim)"* | **200 784 801** | Ing. Gaqe Meçi<br>Ing. Antoneta Çako |

2. Ngarkohet per zbatimin e ketij urdheri Zyra per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve ne Bashkine Gjirokaster.

3. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA GJIROKASTËR

**KRYETARI**

**FLAMUR BIME**

Juristi

Sami Golemi

Scanned by CamScanner

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**BASHKIA E QYTETIT**

**GJIROKASTER**

**Nr**3241**.Prot**

**Date** 08.11.2014

---

# KONTRATE PER PUNE PUBLIKE

Kontrate Publike per kryerjen e punimeve ne objektin;

**"Shetitorja Gjirokaster ,parku i viroit (pedonale dhe ndricim)"**

E lidhur sot me daten **08.11.2014** ne Bashkine Gjirokaster , mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve , bazuar ne dispozitat e Kodit Civil , neni 850 e vijim dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, sipas kushteve te meposhtme:

## KREU I : KUSHTET E VECANTA (PUNET)

*Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.*

**Neni 1 ; Perkufizime**

**Autoriteti Kontraktor eshte Bashkia Gjirokaster,** përfaqësuar nga **Z.FLAMUR BIME** kryetar i Bashkise njohur me poshte si "**AUTORITETI KONTRAKTOR**":

Kontraktuesi eshte **bashkimi i operatoreve ekonomik " Cobial " sh.a me NIPT K02715414M & "Alb-Building " sh.p.k me NIPT J69102508C** me kontrate bashkepunimi Nr 3688 rep. Nr 860 kol, date 15.10.2014 dhe prokure te posacme NR 3689 rep. Nr 861 Kol, date 15.10.2014 per shoqerine **"COBIAL"** sh.a perfaqesuar nga **Z. Odhise BRESHA** perfaqesues ligjor i shoqerise**"Alb-Building "** Sh.p.k dhe **Z.Flamur PAZA** perfaqesues i shoqerise **"COBIAL" sh.a** tani e tutje te quajtur si "**Kontraktuesi"** te cilet perfaqesojne kete bashkim operatoresh per detyrimet e kesaj kontrate.

**Neni 2 : Objekti**

O Bresha

Scanned by CamScanner

Autoriteti Kontraktor **Bashkia Gjirokaster** mbi bazen e dokumentacionit qe disponon pas zhvillimit te procedures se prokurimit me daten **20.10.2014** dhe shpalljes se fituesit per kete procedure, i beson Kontraktuesit kryerjen e punimeve per objektin "**Shetitorja Gjirokaster ,parku i viroit (pedonale dhe ndricim)"** ne baze dhe per zbatim te projektit dhe preventivit te hartuar per kete objekt kundrejt pagimit te vleres se kontrates.

**Neni 3 : Kantieri**

Kantieri i punimeve do te jete rruga **Shetitorja Gjirokaster - parku i viroit** Gjirokaster.

**Neni 4 : Vlera e Kontrates**

Vlera totale e kontrates eshte **200 784 801** ( dyqind milione e shtateqind e tetedhjete e kater mije e teteqind e nje) **leke me t.v.sh**
Financimi per Vitin 2014 eshte **159 662 318** (njeqind e pesedhjete e nente milione e gjashteqind e gjashtedhjete e dy mije e treqinde e tetembedhjete) **leke me TVSH**

**Neni 5 : Data e fillimit dhe perfundimit te punimeve**

Kontraktuesit di t'i jepet leja per t'u futur ne kantier menjehere me lidhjen e kontrates .
Kontraktuesi do te filloje punimet ne daten **08.11. 2014**
Afati i perfundimit te punimeve eshte date **07.05. 2015**
kjo sipas afatit te percaktuar ne dokumentat e tenderit dhe te pranuar nga Kontraktuesi.
Per cdo ndryshim te afatit te punimeve duhet te bien dakord te dy palet me shkrim.
Kontraktuesi do te beje zbatimin e punimeve brenda afatit te punimeve te caktuar ne kontrate duke organizuar punen ne perputhje me VKM nr 42 date 16.01.2008 kreu III .

**Neni 6 : Nderprerja e punimeve**

Kontraktuesi eshte i detyruar te beje nderprerjen e punimeve dhe me pas rifillimin e tyre kur urdherohet nga Autoriteti Kontraktor.
Mbetet e drejte e firmes ndertuese te kerkoje zgjatjen e afatit per perfundimin e punimeve per sa kohe qe punimet jane nderprere nga Autorietit Kontraktor.

**Neni 7 : Sigurimi i Kontrates**

Garancia e kontrates e paraqitur nga sipermarresi para lidhjes se kontrates , sipas modelit perkates te dhene ne dokumentat e tenderit, kap vleren 10% te vleres se kontrates ose ne vlere absolute ***20 078 480 (njezet milione e shtatedhjete e tete mije e katerqind e tetedhjete )leke*** . Kjo shume do te garantoje Autoritetin Kontraktor per permbushjen e detyrimeve Kontraktuale nga sipermarresi.

COBIAL sh.a NDERTIM - IMP - EXP TIRANE - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA GJIROKASTER

ALB BUILDING shpk ALBANIA

Scanned by CamScanner

**Neni 8 : Garancia e Punimeve**

Kontraktuesi eshte i detyruar te garantoje cilesine e mire te punimeve dhe ne perputhje me te gjitha kushte teknike te percaktuar me pare ne preventiv dhe ne dokumentat e tjera ne funksion te tij.

Kontraktuesi garanton Autoritetin Kontraktor per defektet e punimeve qe ai do te realizoje per nje periudhe 12 mujore duke filluar nga dita e marrjes ne dorezim te punimeve.

Shuma e mbajtur per efekt te garanacise se punimeve do te jete 5% e vleres se kontrates dhe nuk do te clirohet deri ne perfundimin e periudhes se garancise (**12 muaj).**

Per defektet e mundshme ne punimet e kryera (te vena re gjate periudhes 12 mujore) Autoriteti Kontraktor garantohet nepermjet garancise per defektet si me siper.

**Neni 9: Siguracioni.**

Nga data e hyrjes ne kantier deri në Afatin e Realizimit së Plote, Kontraktori duhet te siguroje objektin dhe mban pergjegjesi sipas legjislacionit ne fuqi për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

**Neni 10 : Mbikeqyresi i Punimeve**

Autoriteti Kontraktor deklaron se dispozitat qe kane lidhje me realizimin e objektit dhe administrimin e kesaj kontrate i rezervohen titullarit ose perfaqesuesve te tij .

Autoriteti Kontraktor deklaron se ne baze te ligjeve ne fuqi **Mbikeqyres i punimeve do te jete Ing. Gaqe Meçi me nr licence MK 0626/1 dhe Ing. Antoneta Çako me nr licence MK1693.**

Kontraktuesi duhet t'i neneshtohet te gjitha dispozitave te mbikeqyresit te punimeve i cili ka te drejten e verifikimit te kryerjes se punimeve si gjate vazhdimit dhe gjate perfundimit te tyre.

Mbikeqyresi i punimeve do të njoftoje sipermarresin lidhur me çdo difekt para mbarimit të garancise të periudhes së garancise për difektet . Periudha e garancise së difekteve do të shtyhet deri sa të korrigjohen difektet.

Në qofte së sipermarresi nuk e korrigjon difektin brenda afatit të percaktuar në njoftimin e Mbikeqyresit të punimeve ky i fundit do të vleresoje koston e korrigjimit të difektit dhe sipermaresi do të paguaje këtë shume ose Autoriteti Kontraktor do ti mbaje këto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese, ose sigurimi i kontrates.

Perpara fillimit të punimeve sipermarresi do ti paraqese për miratim Mbikeqyresit të punimeve një program në të cilen tregohet menyra e

Scanned by CamScanner

kryerjes së punimeve , grafiku i punimeve Sipermarresi do të plotesoje programin sipas grafikut të parashikuar

**Neni 11 : Inspektimet dhe testimet , marrja ne dorezim e punimeve**

Inspektimet dhe testimet para vertetimit te Mbarimit te Puneve do te perfshijne te gjithe kontrollet, inspektimet, testimet qe do te kryeje Mbikeqyresi i punimeve gjate zbatimit te punimeve , ne zbatim te dispozitave ne fuqi.
Autoriteti Kontraktor mund te beje kontroll te gjithe dokumentacionit qe krijohet ne funksion te kontrates dhe te beje sondazhe ne lidhje me vertetesine e punimeve .Per cdo parregullsi qe ai evidenton i gjithe demi i vihet ne ngarkim Kontraktuesit.
Autorieti Kontraktor do te kryeje verifikimin perfundimtar te punimeve brenda 5 (pese) ditesh nga data e perfundimit te punimeve.
Marrja ne dorezim do te behet nga ana e Autoritetit Kontraktor pas perfundimit te kolaudimit te punimeve.

**Neni 12 : Lloji i Kontrates**

Kontrata është me cmime njesie të bazuar në cmimet e njesise të shprehura në preventivin ne njesi.

**Neni 13 : Ndryshimet e punimeve**

Kontraktuesi nuk ka te drejte te beje ndryshime ne preventivin e paraqitur ne tender te aprovuar per punimet , pervec se atyre te autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
Cdo ndryshim ne sasi do te behet ne baze te nje propozimi teknik te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor si dhe ne baze te llogaritjes perkatese te mbeshtetur ne cmimet njesi per cdo ze pune te parashikuar ne preventiv.
Palet jane te detyruara qe per rastet te paparashikuara ne projekt te zbatojne kerkesat e neneve 860, 862 te Kodit Civil si dhe nenet 35,36/1,2,3,4 te kushteve te pergjithshme te kontrates. Cmimet jashte kontrates caktohen sipas analizave teknike ne fuqi,me vleren ekonomike me te mire.

**Neni 14 : Grafiku dhe menyra e pageses.**

Pagesa do te behet sipas vleres se situacioneve te dorezuara ,duke zbritur paraprakisht garancine e defekteve.
Mund te perpilohen dhe situacione pjesore (per nje pjese te punimeve te kryera).
Kontraktuesi do ti paraqese Mbikeqyresit të punimeve situacionet pjesore për punimet e kryera , duke zbritur pagesat e situacioneve të

Scanned by CamScanner

meparshme , garancine e difekteve në vleren 5 % të vleres së situacionit pjesor .
Mbikeqyresi i punimeve do të firmose situacionin pasi te kontrolloje punen e kryer ne fakt nga sipermarresi dhe do të vertetoje shumen që do t'i paguhet sipermarresit .
Situacionet pjesore te hartohen ne lloje, zera , sasi, cmime vlere,sipas kontrates dhe ndryshimeve te urdheruara nga investitori.
Zerat, sasite, cmimet jashte kontrates dhe perdorimi i fondit rezerve ne situacionin perfundimtar justifikohen me dokumentacionin perkates.(Udhezimi Nr2 dt 13.05.2005KM)
Vlera e punimeve të kryera do të percaktohet nga Mbikeqyresi i punimeve dhe do të perfshije vleren e volumeve të zerave të punimeve të perfunduara dhe të dhena ne preventiv.
Sipermarresi mbas perfundimit të punimeve i paraqet mbikeqyresit të punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare të punimeve të cilat Mbikeqyresi i punimeve mbasi ben verifikimin nga ana e tij së bashku me një relacion ia paraqet, Investitorit.
Pagesa nga ana e investitorit për punimet e kryera do t'i bëhet kontraktuesit me urdher xhirimi në llogarine rrjedhese **AL** [redacted]

Pagesa per Punet e kryera duhet bere brenda 30 diteve nga data qe kontraktuesi paraqet nje dokument (situacionin) qe deklaron se objektivi per pagesen eshte arritur.
Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

**Neni 15 : Detyrimet e Kontraktuesit**

Kontraktuesi (sipermarresi) , me qellim qe te kryeje punen ne kushte e parashikuara ne kete kontrate eshte i detyruar:
- Te perfundoje objektin sipas volumeve, zerave te pecaktuar ne preventiv si dhe ndryshimeve te miratuara , brenda te gjitha kushteve teknike dhe konform kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne dokumentat e tenderit.
- Te interesohet ne kujdesin dhe shpenzimet e tij te beje furinizmin me materiale dhe mjete ne gjendje te mire dhe ne masen e nevojshme per nje zhvillim korrekt dhe te shpejte te punimeve
- Te marre persiper te gjitha pergjegjesit qe rrjedhin nga sigurimi teknik ne pune.

**Neni 16 : Detyrimet e Autoritetit Kontraktor**

Autoriteti Kontraktor ka detyrim:
- Sigurimin e skicave dhe mbikeqyrjen e punimeve
- Caktimi i mbikeqyresit te punimeve
- Marrja ne dorezim e punimeve kur keto te jene kryer sipas kushteve teknike, skicave dhe preventivit te hartuar per kete qellim
- Pagesa e situacioneve.

Scanned by CamScanner

**Neni 17 : Demet**

Kontraktuesi merr persiper pergjegjesine e ruajtjes se punimeve te kryere deri ne castin e dorezimit perfundimtar te punimeve. Demet e mundshme ne punimet e perfunduara ose ne perfundim e siper i ngarkohen firmes sipermarrese , kur per to nuk eshte shkak forca madhore.
Kontraktuesi do te mbaje pergjegjesi per zbatimin e punimeve sipas kushteve te percaktuar ne kete kontrate dhe ne dokumentat e tenderit perkates.

**Neni 18**: **Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 19 : Komunikimi midis paleve**

Komunikimi midis paleve duhet të bëhet vetem me shkrim . Njoftimi bëhet efektiv vetem pasi të dorezohet

**Neni 20 : Gjuha e kontrates.**

Gjuha e kontrates eshte shqip.

**Neni 21 : Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Ne rast mosmarreveshjesh , kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim nga palet , kompetence per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokastër.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**BASHKIA GJIROKASTER**

PËRFAQËSUAR NGA
KRYETARI

**FLAMUR BIME**

**KONTRAKTUESI**
**" Cobial " sh.a** ***dhe***
**"Alb-Building " sh.p.k**
PËRFAQËSUAR NGA
PER **"Alb-Building " sh.p.k**

**Z . Odhise BRESHA**

**"Cobial " sh.a**

**Z. Flamur PAZA**

Scanned by CamScanner

1420
48/3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR**

Nr. 2335/1 prot. Gjirokastër, më 12.05.2018

Lenda: **Kthim pergjigje.**

Derguar : **" QENDRES RESPUBLICA "**

**Tirane**

Mbeshtetur ne shkresen tuaj te dates 28.03.2019 , ku kerkoni informacion dhe dokumentacion ne lidhje me kerkesat tuaja si me poshte sqarojme:

1. A ka perfituar Bashkia juaj projekte ne programin e "Rilindja Urbane"?
   Bashkia ka perfituar projekte ne kuader te programit te mesiperm.
2. Nese po , kopje te listes te projekteve te perfituara ?
   Objektet e perfituara nga bashkia Gjirokaster jane si me poshte :
   - Projekte ne parkun e Viroit(Sistemim i parkut te Viroit, Rikonstruksion i rruges ne parkun e Viroit nga ana e qytetit, Ndriçim i trotuarit ne parkun e Viroit nga ana e qytetit).
   - Rruga prane shtepise se Ismail Kadarese dhe rruga me kalldrem e lagjes Varosh.
   - Projekte te infrastruktures rrugore ne qytet (loti i 1 , 2 ,3).
   - Shetitorja Gjirokaster-Parku i Viroit (pedonale e ndriçim).
   - Rikonstruksion i rruges Sheshi i Çerçizit –Postbllok.
   - Rikonstruksion i hapersirave publike dhe rruges hyrese prane memorialit te Rilindasve ne Gjirokaster.
   - Rikonstruksion i Bulevardit "18 Shtatori" dhe degezimeve , rrugeve "Rexhep Qosja " e "Gole Gushi".

3. Kopje te dokumentave qe lidhen me zbatimine ketyre projekteve.

Kerkojme nga ana juaj te specifikoni dokumentacionin qe kerkoni , pasi dokumentacioni i zbatimit eshte shume voluminoz . Pasi te specifikoni se cilat dokumente doni do ti pergatisim duke paguar paraprakisht pagesat qe parashikohen per keto raste.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GJIROKASTER

**KRYETAR**

**Zamira R A M I**